



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:032267
Datë: 19.11.2024
Numri i dokumentit: 06475698

K.Dh.Sh.II.nr.1600/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve nga Mitrovica kundër debitorit Rojet e Nderit shpk nga Mitrovica, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.867/23 të datës 19.01.2024, me datë 19.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit Rojet e Nderit shpk nga Mitrovica, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.867/23 i datës 19.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.867/23 të datës 19.01.2024, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Rojet e Nderit shpk nga Mitrovica, i ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.1588/22 të datës 08.11.2022 të përmbaruesit privat Atip Mustafa, dhe ka Lënë në fuqi të njëjtin urdhrin përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i ankimuar, dhe çështja të kthehet në rivendosje

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve nga Mitrovica, me datë 08.11.2022 ka paraqitur propozim për përmbaremore kundër debitorit Rojet e Nderit shpk nga Mitrovica, në bazë të dokumentit përmbaremore - Vendimit Nr.17-66/2021 të datës 15.06.2022, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 15.08.2022.

Përmbaremoresi privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me urdhrin P.nr.1588/22 të datës 08.11.2022, ka lejuar përmbaremoren ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbaremore-vendimit të inspektoratit të punës, me të cilin është obliguar debitori që të paguaj borxhin në shumën prej 3,000.00€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Kundër këtij urdhri përmbaremore debitori ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbaremore, me arsyetimin se vendimin për shqiptimin e masës ndëshkimore nuk e ka pranuar për një kohë të gjatë, prandaj nuk ka mundur të dij me kohë për vendimin, andaj ka propozuar që të aprovet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbaremore.

Përgjigje në prapësim nuk ka paraqitur kreditori

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.867/23 të

datës 19.01.2024, me të cilin ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Rojet e Nderit shpk nga Mitrovica, i ushtruar kundër urdhrin përmbarrimor P.nr.1588/22 të datës 08.11.2022 të përmbarruesit privat Atip Mustafa, dhe ka Lënë në fuqi të njëjtin urdhrin përmbarrimor.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsye se vendimi Nr.17-66/2021 dt.15.06.2022 i inspektoratit të punës, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 të LPP-së dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësojnë edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Nr.17-66/2021 dt.15.06.2022, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 15.08.2022, për shumën e detyrimit prej 3,000.00 Euro, në këtë rast është dokument përmbarrues, e kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, me të cilën parashihet se: *“Dokument përmbarrues është edhe vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)”*, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka

bërë shkelje të dispozitave të procedurës procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret vendimi i lëshuar nga kreditori, është dokument përbarimor dhe i përbarueshëm dhe cilësia e tillë është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit as për shkelje tjera të pretenduara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit nuk ka gjetur se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së për aprovim të prapësimit.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1600/24 me datë 19.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha